

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Global Servizi Group “ sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 10/03/2020:

- **Z. Adriano Schiavone**, shtetase Italiane, lindur ne Siragusa( Itali) më03/03/1981 dhe banues në adresën Via Giustiniani ,nr.33, Siragusa, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.AR6605311,

- **Z. Francesco Scilipoti**, lindur me dt. 27/11/1979 , ne Barcellona Pozzo Di Gotto( Itali), dhe banues ne adresen Via Dott. Benedetto Genovesi Nr. 94, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr.AY3605428,

Në cilësinë e “ortakeve themelues”, me vullnetin e lirë, të plotë e të sinqertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 ”Për Qëndrën Komëtare të Regjistrimit”, në atë doganor, fiskal e tatimor, kane themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“Global Servizi Group“ sh.p.k** (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

KREU I

Neni 1  
Krijimi

Shoqëria **“Global Servizi Group“ sh.p.k.** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Global Servizi Group“ sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaket e cila nuk përgjigjet pér detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributiveve të nënshkruara. Kontributi i ortakëve themelues pérben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojnë kuotën e tyre në shoqëri në perpjektim me kuotën që ka dhënë në kapital.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në Tirane Rruga “Deshmoret e 4 Shkurtit“, Pallati nr.27, Shkalla nr.4, katil. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nëpërmjet vendimit vetëm nga Administratorët si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

#### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si qëllim shitblerjen e makinave dhe dhenien me qera te tyre. Shoqeria do te kryej aktivitet ne fushen e ruajtje dhe te mbrojtjes se persona fizik ashtu si dhe te objekteve ose godinave. Sisteme alarmi, vezhgim GPS si dhe te gjitha pajisjet ndihmese, film rezisten kunder sherthemeve, thyerjeve dhe demtimeve, sherbim audio dhe video. Shoqeria do te ofroji dhe sherbime imobilare brenda dhe jashte vendit. Shoqeria do te organizoj dhe eskursione nga Shqiperia ne Itali dhe anasjelltas. Gjithashtu shoqeria do te shtri aktivitetin e saj ne fushen e ndertimit dhe montimit te varkave te permasave te ndryshme dhe do te krye import-eksport. Shoqeria mund te kryej dhe cdo aktivitet tjeter qe konsideron te nevojshem per zhvillimin e aktivitetit te saj qe eshte ne perputhje me ligjin

#### Neni 5

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në (QKR) Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore te papërcaktuar.

Kreu II

Kapitali

#### Neni 6

#### Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë është 10000 Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në 2 kuota me vlerat, si më poshtë:

**Z. Adriano Schiavone**, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit të shoqërise me vlerë 5000 (pesemijë) lek ,

;

**Z. Francesco Scilipoti**, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit të shoqërise me vlerë 5000 (pesemijë) lek,

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërise.

#### Neni 7:

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kaptiali i shoqërisë mund te zmadhohet me vendim të ortakeve duke kontribuar në natyrë ose në para dhe shërbime.Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zvogëlimin e kapitalit deri në vlerën minimale.

Kërkohet vendim i kualifikuar edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Me anë të një vendimit të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

Neni 8:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, duhet të përpilohet dhe firmoset kontratë me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, deri ne çastin e regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqeria eshte e themeluar nga një ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:*

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 10  
Administrimi

Administratori i shoqërisë është Francesco Scilipoti mbajtes i kartes se identiteti me nr AY3605428 , iemëruar në këtë detyrë per një periudh 2 vjecare.

Neni 11  
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.
- f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në

rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Me përashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividentët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15  
Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së përgjithshme.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë asamblesë së përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16  
Dividenti

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondevë ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Asamblesë së Shoqërisë.

Neni 17

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të ortakeve te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqerise.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

#### Neni 19

##### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqérinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### Neni 20

##### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

#### Neni 21

##### Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthitura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive

ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22  
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e passiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja përmarrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23  
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25  
Mosmarrëveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 26

Dispozita përfundimtare


Ky Statut u redaktua ne 3 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakëve themeltar të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tyre.

***ORTAKËT E SHOQËRISË***

**Adriano Schiavone**



**Francesco Scilipoti**



Perkthet e gjuhen italiane Rexha Xhaferi  
Rexha Xhaferi 